



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: sekretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

NJOFTIM PËR POZICIONIN

“Jurist/e dhe Burime Njerëzore”

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, themeluar në vitin 1958, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj. KOKSH është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpike Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj.

Në kuadër të Projektit “**Ekipet Sportive 2022**”, projekt i financuar nga Buxheti i Shtetit, KOKSH, fton kondidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e punës “**Jurist/e dhe Burime Njerëzore**”.

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është krijimi i një Programi Kombëtar që nxit 1) sportin masiv, 2) zbulimin e talenteve, 3) edukatën sportive dhe parimet olimpike. Projektin do të formojë Ekipet sportive jashtë shkollorë në nivelin 9-vjecar (nga klasa e 6 – 9); në nivelin shkollor e mesëm (nga klasa 10 – 12); në universitete.

Detyrat e Juristit/es dhe Burime Njerëzore

Jemi në kërkim të një juristi të kualifikuar, i cili do të merret me të gjitha aspektet ligjore dhe kontraktuale që lindin nga projekti “Ekipet Sportive 2022”. Ky person, pa u kufizuar, do të përfshihet në dhënien e këshillave ligjore, hulumtim ligjor, hartimin dhe negocimin e kontratave që projekti do të lidhë me punëmarrësit apo palët e treta, etj. Gjithashtu, do të përfshihet në gjithë procesin e rekrutimit si dhe do të merret me çështje të tilla si shkeljet e kontratave apo largimet nga puna. Ky person do të jetë sigurohet për respektimin e legjisllacionit shqiptar në të gjitha veprimet dhe detyrimet që ndërmerr projekti, si dhe sigurohet që proceset e prokurimit të jenë konform ligjit. Përfaqëson projektin pranë institucioneve administrative dhe ndjek procedurat ligjore, ankimimet, prapsimet, korrespondencat zyrtare me autoritetet shtetërore për çështje të ndryshme ligjore. Ky person raporton tek Drejtori i Projektit. Për të përmbushur objektivat e caktuara Juristi duhet të ketë:



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: secretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

Kualifikimet dhe Eksperienca:

- Të ketë mbaruar arsimin e lartë për Drejtësi;
- Të ketë të paktën 5 vjet eksperiencë pune si Jurist/e;
- Preferohet të ketë eksperiencë si jurist në projekte të përmasave të ngjashme, çeshtjet gjyqësore apo prokurime publike;
- Të zotërojë në nivel shumë të mire gjuhën Angleze;

Aftësi dhe kompetenca kryesore

- Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi, prezantimi dhe pune në grup;
- Të ketë aftësi shumë të mira në formulimin e qartë të mendimit juridik dhe shkrimit të tij sipas formateve të kërkuara;
- Përqasje pro-aktive në punë;
- Të ketë njohuri të metodave të ndryshme të menaxhimit të projektit;
- Të zotërojë në nivel shumë të mire "Paketën Office";
- Aftësi drejtuese shumë të mira.

Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin Europass;
- Letër Interesi;
- Fotokopje të diplomave universitare;
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Kandidatët e interesuar duhet t'i dërgojnë dokumentet e aplikimit deri më datë 12 Maj 2022, ora 16.00, në adresën secretary.general@nocalbania.org.al, me subjekt: **Aplikim për pozicionin Jurist/e dhe Burime Njerëzore "Ekipet Sportive 2022"**